LIGJ
Nr. 3/2018

PËR **RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, SI ADMINISTRATOR I FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA QEVERI TË NDRYSHME, NËN FONDIN E PËRBASHKËT EUROPIAN TË BALLKANIT PERËNDIMOR, PËR PROJEKTIN E DETAJUAR TË LINJËS HEKURUDHORE DURRËS–TIRANË DHE VLERËSIMIN FINANCIAR/EKONOMIK TË TË GJITHË RRJETIT HEKURUDHOR NË SHQIPËRI, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 63/2015**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruara nga qeveri të ndryshme, nën Fondin e Përbashkët Europian të Ballkanit Perëndimor, për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Durrës–Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor në Shqipëri, të ratifikuar me ligjin nr. 63/2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.1.2018

Shpallur me dekretin nr. 10721, datë 6.2.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE NDRYSHIMI
TË MARRËVSHJES SË GRANTIT TË DATËS 13 MARS 2015

Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave "Marrësi" dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim "Banka" apo "BERZH-i", si administrues i fondeve të grantit të dhëna nga qeveri të ndryshme, nën fondin e përbashkët të vendeve evropiane të Ballkanit Perëndimor, për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Durrës–Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor shqiptar.

Kjo Marrëveshje Ndryshimi e datës 7.4.2017 lidhet ndërmjet:

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Marrësi); dhe

2. Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim "Banka" ose "BERZH-i".

Meqë Përfituesi dhe BERZH-i lidhën Marrëveshjen e Grantit në datën 13 mars 2015 (Marrëveshja Fillestare e Grantit), në vijim të së cilës BERZH-i ra dakord të vërë në dispozicion fonde në shumën 1,103,000.00 euro, si grant (Granti) për të financuar shërbimet e konsulencës së një Konsulenti për projektin e detajuar të Linjës Hekurudhore Durrës–Tiranë dhe vlerësimin financiar/ekonomik të të gjithë

Rrjetit Hekurudhor Shqiptar.

Me anë të letrës së datës 21 korrik 2016, Marrësi i kërkoi BERZH-it të japë financim shtesë në shumën 112,000 euro për shërbime konsulence shtesë, me qëllim përgatitjen e koncept-projektit për seksionin hekurudhor Terminali i Transportit Publik Tiranë (TTP) - Stacioni i Trenit Tiranë.

Bazuar në sa më sipër, palët kanë rënë dakord të ndryshojnë pjesët e mëposhtme të Marrëveshjes Origjinale të Grantit, si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime

Përcaktimi i shumës maksimale të Kontratës do të ndryshojë si më poshtë:

"Shuma maksimale e Kontratës" nënkupton shumën maksimale deri në 1,215,000.00 euro, që i paguhet Konsulentit në bazë të Kontratës së Konsulencës, ku përfshihen të gjitha tarifat, dietat dhe shpenzimet.".

Neni 2
Granti

Shuma e Grantit ndryshon nga "1,103,000 euro" në "1,215,000 euro".

Në dëshmi të kësaj, palët, me anë të përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje Ndryshimi, në dy kopje, në gjuhën angleze. Kjo Marrëveshje Ndryshimi hyn në fuqi ditën kur Marrësi njofton BERZH-in për përfundimin e procedurave të brendshme të miratimit.

Për dhe në emër të Marrësit:
Këshilli i Ministrave i Republikës
i përfaqësuar nga Ministria e Financave
_____
Emri: Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
Datë 7.4.2017

Për dhe në emër të Bankës Evropiane
për Rindërtim dhe Zhvillim
_____
Steve Gillard
Drejtor i Asociuar
Drejtues i Operacioneve TC
Bashkëpunimi Teknik
Datë 25.11.2016